**URDHËR I PËRBASHKËT**
**Nr.9099, datë 3.12.2004**

**PËR NUMRIN E KAZINOVE SIPAS ZONAVE TË PËRCAKTUARA NË VENDIMIN NR.622, DATË 12.11.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8701 datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" me propozim të Komitetit të Lojërave të Fatit, Ministri i Financave dhe Ministri i Rendit Publik

URDHËROJNË:

Numri i kazinove sipas zonave të përcaktuara në vendimin nr.622, datë 12.11.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e zonave ku mund të hapen kazinotë", janë si më poshtë:

a) Zona bregdetare turistike Vlorë 1(një)
b) Zona bregdetare turistike Sarandë 1(një)
c) Zona bregdetare turistike Durrës 1(një)
d) Zona turistike Velipojë 1(një)
e) Qyteti i Tiranës 1(një).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
**Arben Malaj**

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
**Igli Toska**